



RR E G U L L O R E

MBI MBROJTJEN NË PUNË – MBROJTJE TË SHËNDETIT TË TE PUNËSUARVE DHE AMBIENTIT TË PUNËS

PRISHTINË, Shkurt 2010

Në bazë të dispozitës së nenit 18 të Ligjit Nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të te Punësuarve dhe Ambientit të Punës në Republikën e Kosovës, dispozitave adekuate të Statutit të Universitetit për Biznes dhe Teknologji "UBT-e", Prishtinë, Pronari i këtij subjekti ekonomik të Arsimit të Lartë Privat, më datën **23/04/2010**, nxori këtë:

RR E G U LL O R E

MBI MBROJTJEN NË PUNË – MBROJTJE TË SHËNDETIT TË TE PUNËSUAARVE DHE AMBIENTIT TË PUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Më këtë Rregullore mbi mbrojtjen në punë – mbrojtje të shëndetit të te punësuarve dhe ambientit të punës (**në tekstin e mëtejmë: Rregullorja**), rregullohet në mënyrë të tërësishme kushtet si dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme që kanë të bëjnë lidhur më mbrojtjen në punë – mbrojtje të shëndetit të te punësuarve si dhe ambientit të punës të punonjësve tek Universiteti për Biznes dhe Teknologji "UBT-e", Prishtinë, (**në tekstin e mëtejmë shkurt: UBT-e**).

Neni 2.

Më këtë rregullore më përafërt rregullohen çështjet si në vijim,

- të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e punonjësve sa i përket mbrojtjes në punë si dhe mbrojtjes së shëndetit,
- programin e masave të mbrojtjes në punë,
- mësimet nga lëmi i mbrojtjes në punë,
- dërgimi i punonjësve në shikime mjekësore,
- mbrojtja e posaçme e të rinjve, femrave dhe invalidëve,
- mënyra e dhëties të ndihmës së parë në rast fatkeqësie në punë, ndodhisë së zjarrit si dhe fatkeqësive natyrore,

- mënyrën e përbushjes së obligimeve kundrejt autoritetit të Inspektoratit të Punës,
- çështje tjera në pajtim më ligjin si dhe standardet evropiane.

Neni 3.

Më implementimin e kësaj rregulloreje, do të arrihet në parandalimin e lëndimeve eventuale të punonjësve në punë, mbrojtjen e shëndetit të tyre, ashtu që punonjësit gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës të punojnë pa rrezikshmëri të lëndimeve trupore apo jetës dhe pa dëmtuar shëndetin e tyre, krejt kjo edhe më qëllim së jetëgjatësisë të punës së punonjësit.

Neni 4.

Dispozitat e kësaj rregulloreje kanë të bëjnë dhe do të aplikohen, si më poshtë,

- kundrejt të gjithë punonjësve të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune më këtë subjekt afarist,
- personat të cilët janë në aftësim profesional tek UBT-e, por të cilët nuk kanë themeluar marrëdhënie pune,
- personat që gjenden në UBT-e më qëllim mësim nxenjeje, etj.,
- nxënësit apo edhe studentet të cilët në UBT-e kryejnë punët praktike, dhe
- personat të cilët gjenden në objektet e UBT-se (*profesorët, asistentet, bashkëpunëtorët profesional, shfrytëzuesit e shërbimeve, vizitorët etj.*).

Neni 5.

Masat të cilat ndërmerren për sendërtimin sa më të mirë të kushteve të punës për të punësuarit, do të implementohen duke aplikuar metodat më të reja teknike dhe shkencore, si dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mënjanimin e të gjitha rreziqeve për jetë dhe shëndet të te punësuarve.

II. ORGANIZIMI DHE SENDËRTIMI I MBROJTJES NË PUNË

Neni 6.

Nëse UBT-e punëson më shumë së 50 punonjëse dhe më pak së 250 të punësuar, do të punësoj një (1) punonjës në cilësinë e REFERENTIT PËR SIGURI NË PUNË (*agjent për siguri në punë*).

Neni 7.

Në nomenklaturën e punëve dhe detyrave të punës, punonjësi – Referent për Siguri në Punë (*agjenti për siguri në punë*), duhet të kryej sidomos këto punë:

- organizon, përgatitë dhe zbaton punë profesionale nga lëmi i mbrojtjes në punë, mbrojtje të shëndetit të te punësuarve dhe ambientit të punës,
- përgatitë analizat, raportet si dhe propozimet lidhur më mbrojtjen në punë si dhe masat të cilat duhet ndërmarrë,
- përpunon konstatimet e Inspektoratit të Punës dhe propozon masa përkatëse për mënjanimin eventual të te metave përkufizuar nga Inspektorati i Punës,
- analizon fatkeqësitë respektivisht lëndimet e ndodhura në punë, mban evidencën e ndodhive (lëndimeve në punë), përkujdeset për dërgim të punonjësve në kontrollime sistematike mjekësore, si dhe propozon ndërmarrjen e masave për mënjanimin e shkaqeve që fatkeqësitë respektivisht lëndimet në punë të mos ndodhin më gjegjësisht ato të zvogëlohen në minimumin e mundshëm,
- propozon sendërtimin e formave të reja mbrojtjes në punë, mbrojtje të shëndetit të te punësuarve dhe ambientit të punës,
- iniciion procedurën si dhe propozon ndërrimin apo edhe miratimin e RI të akteve normative që kanë të bëjnë lidhur më mbrojtjes në punë, mbrojtje të shëndetit të te punësuarve dhe ambientit të punës,
- jep ndihmë profesionale punonjësve lidhur më njojurit për së afërmi nga lëmi i mbrojtjes në punë, mbrojtje të shëndetit të te punësuarve dhe ambientit të punës,
- përcjellë dhe studion gjendjen e mbrojtjes në punë, e sidomos sa i përket obligimeve të punonjësve për mbajtjen e mjeteve për mbrojtje në punë,

- mban kontakte më Inspektoratin e Punës dhe Mjekësinë e Punës, paraqet raporte, siguron vendndodhjen e fatkeqësisë në punë dhe provat materiale,
- ndihmon në përpilimin e teksteve për shtruarjen e Plakateve përkatëse nga lëmi i mbrojtjes në punë, mbrojtje të shëndetit të te punësuarve dhe ambientit të punës, si dhe
- kryen edhe punë tjera në përputhje më ligjin dhe këtë rregullore.

Neni 8.

Më qëllim të ofrimit të kushteve optimale të mbrojtjes në punë si dhe mbrojtje të shëndetit të te punësuarve, apo edhe sëmundjes së papritur, UBT-e siguron sidomos:

- dhënien e ndihmës së parë si formë e ndihmës urgjente,
- evakuimin e punonjësit të lënduar nga vendi i lëndimit,
- vënien e menjëherëshme të kontakteve më Ndihmën e Parë dhe Inspektoratin e Punës, respektivisht Shërbimin Policor
- ndërmarrjen e të gjitha masave për mbrojtjen nga zjarri, konformë Ligjit mbi Mbrotjen nga Zjarri dhe Rregullores mbi Mbrotjen nga Zjarri, nëse zjarri ka qenë shkaktar i lëndimit të punonjësit në punë, si dhe
- të bëjë aftësimin e një numri të konsiderueshëm të te punësuarve për dhënien e ndihmës së parë, si dhe shpëtimin dhe evakuimin e punonjësve në rast rreziku nga zjarri, tërmetit, vërvshimeve etj.

Neni 9.

Në rast të ndodhive të ç'ashtuquajtura Fatkeqësi Natyrore (*vis major*), siç mund të jenë: tërmeti, vërvshimet, zjarri në masë të gjerë etj., UBT-e duhet organizuar evakuimin si dhe shpëtimin e punonjësve dhe njerëzve tjerë (konsumatorëve, miqve afarist, vizitorëve të rastit etj.) të cilët gjendën në ndërtesën e UBT-se.

Planin për evakuim si dhe shpëtim të punonjësve, subjekti afarist duhet nxjerrë që nga momenti kur në nivel të UBT-se janë të punësuar më shumë së **20 punonjës.**

Neni 10.

UBT-e është e obliguar që të gjitha pajisjet elektrike të kenë Tiketën përkatëse, në të cilën shënohet sidomos karakteristikat e tyre më prefiksin (*simbolin*) CE.

Instalimet e rrymës duhet bërë sipas standardeve të caktuara teknike në pajtim më standardet përkatëse Evropiane (EN).

III. TË DREJTAT, DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSIT E PUNONJËSVE

Neni 11.

Punonjësit e UBT-se janë të obliguar që të t'u përmbahen dispozitave të kësaj rregulloreje, ligjit dhe akteve tjera nënligjore, më qëllim të sendërtimit të mbrojtjes në punë, mbrojtje të shëndetit të te punësuarve dhe ambientit të punës.

Neni 12.

Më rastin e themelimit të marrëdhënieς së punës, punonjësi detyrimisht duhet njoftuar më normat ligjore dhe masat përkatëse të mbrojtjes në punë, mbrojtjes së shëndetit si dhe ambientit të punës.

Neni 13.

Punonjësi është i obliguar që punët dhe detyrat e punës t'i kryej më ndershmëri dhe përkujdesje për ruajtjen e shëndetit dhe jetës së tij, si dhe ruajtjen e shëndetit dhe jetën të te punësuarve tjerë.

Punonjësi duhet që dijen e tij nga lëmi i mbrojtjes në punë çdoherë ta perfeksionoj.

Neni 14.

Nëse punonjësi para fillimit të orarit të punës vëren prishje të pajisjeve për punë, ose rrethana tjera të cilat mund të ndikojnë në rrezikshmërinë e punonjësve ose pasurisë, punonjësi duhet që këto parregullsi t'i mënjanoj vetë, dhe nëse këtë vetë nuk mund t'a bëjë është i detyruar që të njoftoj menjëherë udhëheqësin e tij për ndërmarrjen e masave për mënjanimin e këtyre të metave dhe parregullsive.

Neni 15.

UBT-e ka për detyrë që drejtpërdrejt **Inspektoratin për Punë t'a njoftojë** për secilin fatkeqësi (*lëndim*) të ndodhur në punë të te punësuarve, si dhe për cilëndo rrjedhë tjetër e cila mund të rrezikoj shëndetin dhe jetën e punonjësve.

IV. VENDET E PUNËS MË KUSHTE TË VEÇANTA PUNE

Neni 16.

Në nivel të UBT-se nuk është vlerësuar të ketë vend punë më kushte të veçanta për punë, kushte këto të cilat do të mund të paraqitnin rrezik për lëndim në punë të punonjësve, më ç'rast do duhej ndërmarr masa të posaçme për mbrojtje në punë dhe/apo mbrojtje të shëndetit të te punësuarve.

V. MBROJTJA E POSAÇME E FEMRAVE, TË RINJVE DHE INVALIDVE

Neni 17.

Në UBT-e është e **NDALUAR** që gratë shtatzëna, të rinjtë nën moshën 18 vjeç, si dhe personat më aftësi të kufizuar pune (*invalidët e punës etj.*), që të sistemohen në punë veçanërisht të rënda, në punë më gjatë së orari i plotë i punës, si dhe në të ashtuquajturën punë të natës.

VI. MASAT E MBROJTJES NË PUNË

Neni 18.

Më qëllim të formimit të kushteve dhe parakushteve për ruajtjen e shëndetit të te punësuarve, UBT-e do të vejë në dispozicion të punonjësve, si në vijim:

- tualete në numër të mjaftuar, dhe atë ndaras për femra dhe ndaras për meshkuj,
- restorantin për të ngrënje,
- ngrohjen gjatë sezonit të dimrit, si dhe
- sasi të mjaftueshme uji të pijshëm.

Neni 19.

UBT-e siguron së vendet e lokalët e punës përgjithësisht do të jenë të ndriçuara më ndriçim të mjaftueshëm, qoftë ai ndriçim natyral apo/edhe ndriçim artificial.

Neni 20.

UBT-e siguron gjithashtu së, niveli i zhurmës, niveli i dridhjeve si dhe niveli i ndriçimit, do të rregullohen dhe të njëjtat do të sillën në kufijtë e limituar (*lejuar*) në pajtim të plotë më minimumin e standardeve të Bashkësisë Evropiane.

Neni 21.

Lokalet ku zhvillohet procesi i punës, si dhe depot ku është i vendosur malli për shitje, do të jenë të pajisura më mjete më mjete përkatëse për mbrojtje kundër zjarrit, në pajtim më ligjin, Rregulloren mbi mbrojtjen nga zjarri, këtë rregullore, si dhe Planin Emergjent.

VII. DOKUMENTACIONI DHE SHËNIMET

Neni 22.

UBT-e do të mbajë në mënyrë të rregullt dhe në vazhdimësi sidomos,

- certifikatat gjegjëse në të cilat do të specifikohet aplikimi i rregullave të sigurisë në punë, shëndetin e të punësuarve dhe ambientin e punës (*për lokalet, pjesët e lokaleve, zyrave etj.*),
- evidencën mbi kontrollimin mjekësor të punonjësve të caktuar në vendet e punës ku kontrollimi mjekësor periodik sipas ligjit është i detyrueshëm,
- evidencën e lëndimeve në punë (*të cilidto nivel qofshin ato*), si dhe rastet e sëmundjeve profesionale nëse ka raste të tilla,
- evidencën e vlerësimeve për rreziqet në punë, masat e ndërmarra për mënjanimin e atyre rreziqeve, si dhe rezultatet e këtyre efektshmërive, si dhe

- çdo ndryshim të bërë teknologjik që rrezikojnë ose mund të paraqesin rrezik për sigurinë në punë të te punësuarve, mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe ruajtjes së ambientit të punës.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23.

Çdo gjë që nuk është paraparë më këtë rregullore, aplikohen dispozitat gjegjëse të Ligjit për Sigurinë në Punë – Mbrojtje të Shëndetit të te Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe aktet tjera nënligjore.

Neni 24.

Ndryshim plotësimet e kësaj rregulloreje behën në procedurë të njëjtë, e cila vlen për nxjerrjen respektivisht miratimin e sajë.

Neni 25.

RREGULLORJA HYNË NË FUQI MENJËHERË, dhe atë që nga momenti i nxjerrjes të së njëjtës respektivisht që nga data **23/04/2010**.

PRISHTINË,

Datë, 23/04/2010

Presidenti i UBT-së,

Prof. Dr. Edmond Hajrizi